ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-24-4595-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ri tender Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve te institucioneve të arsimit dhe, Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve te QKMF, QMF -se dhe QMU-se**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Rojet E Nderit SH.P.K.**
NUI	**810519209**
Adresa	**Prishitnë**
Vendi	**Prishtinë**
Kodi postar	**10 000**
Numri Telefonit	**044 373 321**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Gëzim Paçarizi**
Adresa elektronike	**info@rojetenderit.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**17.06.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Loti 1, Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve te institucioneve të arsimit[|Loti 2 Sigurimi fizik i objekteve te QKMF, QMF -se dhe QMU-se

Njofitmi per kontrate

Hapja e planifkuar 18.06.2024

Kerkesa per rishqyrtim 12.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

po por nuk na eshte shqyrtuar sipas afatit ligjor

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës .
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 49 Mënyra e Dërgimit të Kërkesave për Pjesëmarrje
Neni 50 Dërgimi dhe Përmbajtja e Ftesave për Tender
Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pasi qe AK sipas afatit në LPP nuk ka shqyrtuar kerkesen tonë ne po e rishkruajm Me shkarkimin e DT-së dhe shiqimin e kritereve ne pamë që DT-ja përmban elemente diskriminuese të cilat e tkurrin konkurencen e gjerë dhe të drejtë. Kriter diskriminues dhe I paqartë është Kërkesa 2. c)Licenca dhe Autorizimi për një klient aktiv për Shërbimet e Vëzhgimit Elektronik te Pronës sipas Ligjit Nr.04 L-004 për Shërbimet Private te Sigurisë(vali de); d)Licenca dhe Autorizimi për një klient aktiv për Shërbimet e Tubimeve Publike sipas Ligjit Nr.04 L-004, për Shërbimet Private te Sigurisë. Këkresa që klientetë të jenë aktiv mendojm se është shumë e padrejtë pasi që siq edhe jeni në dijeni tubimet publike janë të rralla dhe se është e padrejtë ose edhe elektronik, mendojm se do ishte e mjaftueshme që OE të kenë të paktën autorizimet e më parëshme. Kërkesa 3.Operatori ekonomik duhet te caktoj minimum (1) menaxher te projektit me vendim i cili ka përvoje pune min.3 vite është i certifikuar për menaxhim risku dhe i licencuar nga MPB si menaxher i sigurimit zyrtar ne detyre si për shërbimet themelore dhe te specializuara. Dy (2) ndihmës për projekt menaxherin te cilët duhet te ketë përfunduar me sukses trajnimin e specializuar për menaxher të sigurimit zyrtar në detyrë dhe të posedojë licencën vali de të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme - kërkesë e vlefshme për te dy lotet.

Kerkes tejet e paqartë dhe e panvojshme është edhe Operatori ekonomik duhet te caktoj minimum (1) menaxher te projektit me vendim i cili ka përvoje pune min.3 vite është i certifikuar për menaxhim risku dhe i licencuar nga MPB Për vlerësim të rriskut nuk egziston diqka e tillë sipas Ligjit për Siguri Private dhe si e tillë mendojm se është e panevojëshme dhe mendojm se mjafton vetëm licensa për SHSTH. Po ashtu lidhur me

pagën ju keni kërkuar që: 1. Duke marr parasysh rendësin e objekteve qe duhet te ruhen si dhe nivelin stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçante për AK. Paga minimale Bruto bazë (pa aplikimin e tatimeve, kontributeve dhe lejimeve konform Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ne fuqi), për roje fizike të angazhuar ne ketë kontratë duhet të jetë jo me pak se 350 €/muaj, kurse për projekt menaxherin 450 € bruto dhe për ndihmës menaxherin 400 € bruto. Ky çmim është për ndërrimin e pare (orët e ditës).

Kontraktuesi është i obliguar qe respektoj Ligjin e punës, Udhëzimin Administrativ te MPMS Nr. 09/2013 dhe te paguaj shtese mbi pagën Bruto bazë kërkesat e dala nga Ligji i Punës. 2. OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analizë duhet te përfshijë se paku: o Pagat Bruto për punëtorë me te gjitha kontributet dhe tatimet, o Pushimet vjetore, ndërrimet e natës, ndërrimet gjate vikendeve dhe festat shtetërore, o Shpenzimet operative, përfshirë vlerën për uniforma verore dhe dimërore sipas specifikacionit ne dosje te tenderit dhe shpenzimet tjera, fitimin e paraparë, o Çmimi i furnizimit te këtyre artikujve/kostove duhet te llogaritet dhe inkorporohet ne çmimin e orëve ne tabelën e specifikimit te çmimit. Me tërë këto këresa shifet qartë se ka tejkalim bugjeti dhe ne si OE kemi përvoj jo të mirë me AK pasi që për më shumë se 5 vite kemi kërkuar të drejtën tonë pasi që nuk ishte I lejuar tejkalimi I bugjetit. Andaj kërkojm të bëni të QARTË se qka do të veporhet me OE të cilat tejkalojn bugjetin.

PANEL i nderuar i OSHP-së ju veq se jeni në dijeni se si shkas i kritereve të paqarata kemi pasur pë më shum se 5 vite vlersim jo te drejt dhe te sakt nga ana AK-së duke mos ofuar qartesit e duhura andaj kerkojm qe te APROVONI ankesen tone dhe te detyronii AK qe sipas LPP-së të veproj për qartesim të kritereve.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te shumta duke na kercnuar nga e drejta e pjesemmarjes

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*